

VENDIM
Nr. 726, datë 28.8.2013

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr. 9000, datë 31.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 17 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për vitin 2013, në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, të shtohen “Shpenzimet operative” për 11 000 000 (njëmbëdhjetë milionë) lekë, duke pakësuar përkatësisht:

a) Në programin “Mbështetje për zhvillim ekonomik”, në zërin “Pagat”, pakësohet fondi në shumën 8 700 000 (tetë milionë e shtatëqind mijë) lekë, ndërsa në zërin “Sigurime shoqërore” pakësohet fondi në shumën 1 000 000 (një milion) lekë;

b) Në programin “Mbështetje për energjinë”, në zërin “Pagat”, pakësohet fondi në shumën 400 000 (katërqind mijë) lekë, ndërsa në zërin “Sigurime shoqërore” pakësohet në shumën 400 000 (katërqind mijë) lekë;

c) Në programin “Mbështetje për mbikëqyrjen e tregut, infrastrukturë cilësie dhe pronësi industriale”, në zërin “Paga”, pakësohet fondi në shumën 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

2. Fondet e lira në programin “Mbështetje për zhvillim ekonomik”, në zërin “Shpenzime operative”, në QKL, prej 3 000 000 (tre milionë) lekësh, të transferohen në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, për mbulimin e shpenzimeve për vendimet gjyqësore.

3. Vlera totale prej 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekësh, sipas pikave 1 dhe 2, të përdoret për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duke shlyer pagesat përkatëse.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha